



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.6

4 shkurt

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.23, datë 14.1.2009	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë, dhe miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit për këto programe, në Universitetin e Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	89
Vendim i KM nr.24, datë 14.1.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Progër të qarkut të Korçës	90
Vendim i KM nr.25, datë 14.1.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dardhas të qarkut të Korçës	91
Vendim i KM nr.26, datë 14.1.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Qerret të qarkut të Shkodrës	93
Vendim i KM nr.29, datë 14.1.2009	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të dytë, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit për këto programe, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, për vitin akademik 2008-2009	94
Vendim i KM nr.36, datë 14.1.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Meshanik dhe Guvë”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	95
Vendim i KM nr.37, datë 14.1.2009	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Pobreg”, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	95

Vendim i KM nr.40, datë 14.1.2009	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik	96
Vendim i KM nr.41, datë 14.1.2009	Për miratimin e dhënies së lejes së koncesionit “Armo” sh.a., Tiranë, për përpunimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre	100
Udhëzim i MF dhe METE nr.385, datë 16.1.2009	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”	102
Udhëzim i MF nr.7, datë 22.1.2009	Për formatin e gjobës	108
Udhëzim i MF nr.8, datë 26.1.2009	Për përcaktimin e skemës së duhur për shtypjen e biletave, shpërndarjen dhe kontrollin e hedhjes së tyre në përdorim	110
Udhëzim i MTKRS nr.504, datë 22.1.2009	Për rijetëzimin e monumenteve të kulturës	112
Vendim i ERE nr.2, datë 22.1.2009	Për fillimin e procedurave për ndryshimin e licencës së shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k. me nr.16, seria PV04P, për prodhimin e energjisë elektrike, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.49, datë 22.7.2004.....	113
Vendim i ERE nr.3, datë 22.1.2009	Për fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.....	113
Vendim i ERE nr.4, datë 22.1.2009	Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2009	114
Vendim i ERE nr.5, datë 22.1.2009	Për fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar	114
Vendim i ERE nr.6, datë 22.1.2009	Për miratimin e kontratës për furnizim energjie elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (furnizuesi publik me pakicë) për periudhën 1.7.2008 deri më 31.12.2008	115
Vendim i ERE nr.7, datë 26.1.2009	Mbi shtyrjen e afatit të zbatimit të tarifave të shërbimit dhe çmimeve të shitjes me pakicë dhe shumicë të energjisë elektrike ...	116

VENDIM
Nr.23, datë 14.1.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË, DHE MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Universitetin e Tiranës, të programeve të studimit, master i nivelit të parë, sipas fakulteteve, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Në “Teknologji informacioni”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në teknologji informacioni.

b) Në Fakultetin e Infermierisë:

i) Në “Menaxhim infermieror”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, në menaxhim infermieror;

ii) Në “Mami”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, për mami;

iii) Në “Teknik laborator”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë”, MNP, për teknik laborator.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Kuota e pranimeve në këto programe, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2008-2009, të jetë, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Në “Teknologji informacioni” 30

b) Në Fakultetin e Infermierisë:

i) Në “Menaxhim infermieror” 100;

ii) Në “Mami” 50;

iii) Në “Teknik laborator” 50.

4. Universiteti i Tiranës shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij në masën jo më pak se 30 për qind, për studentët, që kanë përfunduar, të paktën, ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 për qind, për ata, që i kanë përfunduar këto studime pranë këtij universiteti. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë Universiteti i Tiranës ka të drejtë ta plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar pranë tij. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, përcaktuar nga njësitë kryesore të Universitetit të Tiranës, bëhen publike paraprakisht.

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, do të jetë, si më poshtë vijon:

a) Në Fakultetin e Shkencave të Natyrës:

i) Në “Teknologji informacioni” 70 000 lekë.

b) Në Fakultetin e Infermierisë:

i) Në “Menaxhim infermieror” 55 000 lekë;

ii) Në “Mami” 60 000 lekë;

iii) Në “Teknik laborator” 60 000 lekë.

6. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si të verbrit, të shurdhët, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentët me aftësi të kufizuar, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë a të plagosur për shkak të detyrës, të ish-të përndjekurve politikë, që fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, master i nivelit të parë, në institucionet publike të arsimit të lartë, të paguajnë 50 për qind të tarifës së shkollimit.

7. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

8. Në çdo program studimi, master i nivelit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik pasardhës.

9. Kuotat e pranimeve në programet e studimit master i nivelit të parë, sipas pikës 3 të këtij vendimi, që mbeten të parealizuara, rishpërndahen, sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

10. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Universitetin e Tiranës.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.24, datë 14.1.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS PROGËR TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Progër të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Progër të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.732, datë 7.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Progër të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Progër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-25	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në mbrojtjen civile.	Në pronësi
26-33 (vetëm trojet e lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
26-33 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
34-41	Varrezat publike	Në pronësi
42-54	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturale e sportive.	Në pronësi
55-63	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
64-68	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
263-285	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
286-299 345,347,370,388,400,415, 419,425	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
305-321	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
430-437	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM**Nr.25, datë 14.1.2009****PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DARDHAS TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Dardhas të qarkut të Korçës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Dardhas të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.359, datë 27.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dardhas të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Dardhas për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Dardhas		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
32-44	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
25-31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
1-4	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
5-24	Varrezat publike	Në pronësi
45	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
46-54 (vetëm trojet e lira)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
46-54 (vetëm sheshet)	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
343-362	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
363-380	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
381-400, 414, 416	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
419-427	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.26, datë 14.1.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS QERRET TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Qerret, të qarkut të Shkodrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qerret të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.297, datë 12.3.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qerret të qarkut të Shkodrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qerret për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qerret	Lidhja nr.1	
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-17	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
18-21	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
22-33	Varrezat publike	Në pronësi
37-97	Infrastrukturë (rrugë vendore).	Në pronësi
99-118	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
805-817	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.29, datë 14.1.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË DYTË, DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, FAKULTETI I EKONOMISË, PËR VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42, e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë, të programeve të studimeve të ciklit të tretë, me kohë të pjesshme, si më poshtë:

a) Master i nivelit të dytë, në “Administrim biznesi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND);

b) Master i nivelit të dytë, në “Administrim publik”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND);

c) Master i nivelit të dytë, në “Financë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND);

ç) Master i nivelit të dytë, në “Kontabilitet”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND);

d) Master i nivelit të dytë, në “Marketing”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MMD);

dh) Master i nivelit të dytë, në “Studime ekonomike europiane”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë”(MMD).

2. Këto programe studimi të realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre të jetë 100 javë mësimore.

3. Kuotat e pranimit në programet e studimeve “Master i nivelit të dytë”, pranë Universitetit të Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë, për vitin 2008-2009, të jenë:

a) Master i nivelit të dytë, në “Administrim biznesi” 70 studentë;

b) Master i nivelit të dytë, në “Administrim publik” 70 studentë;

c) Master i nivelit të dytë, në “Financë” 37 studentë;

ç) Master i nivelit të dytë, në “Kontabilitet” 37 studentë;

d) Master i nivelit të dytë, në “Marketing” 37 studentë;

dh) Master i nivelit të dytë, në “Studime ekonomike europiane” 37 studentë.

4. Tarifa e shkollimit të jetë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për çdo program studimi, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Studimi i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, duke e likuiduar në dy këste të barabarta, në fillim të çdo viti akademik.

6. Studentët e shkëlqyer nga cikli paraardhës i studimeve nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

7. Këto programe studimi do ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.36, datë 14.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “MESHANIK DHE GUVË” DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Meshanik dhe Guvë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Drini 2000” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Meshanik dhe Guvë”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i tyre.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.37, datë 14.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “POBREG”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Pobreg”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 3 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Frigo Food Energy Invest”, sh.a.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën konkurruese, për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Pobreg”, të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta, për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.40, datë 14.1.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIMIN SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI MBI BASHKËPUNIMIN SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Malit të Zi, këtu quhen “Palë kontraktuese”;

Me besimin që bashkëpunimi dypalësh në fushën e shkencës dhe teknologjisë do të forcojë marrëdhëniet miqësore dhe mirëkuptimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi;

të ndërgjegjshëm për rëndësinë e bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik për përmirësimin e zhvillimit ekonomik dhe social të të dy vendeve,

kanë ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese kontribuojnë për zhvillimin e bashkëpunimit bilateral shkencor dhe teknologjik mbi bazën e përfitimit dhe barazisë reciproke, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ligjeve dhe rregulloreve të brendshme të çdo pale, rregulloreve të organizatave ndërkombëtare, ku secila palë kontraktuese është anëtare.

Neni 2

Bashkëpunimi shkencor dhe teknologjik ndërmjet institucioneve shkencore dhe subjekteve ekonomike dhe të tjera, kanë veçanërisht format e mëposhtme:

- a) realizimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit, zhvillimit dhe projektimit në fushat e rëna bashkërisht dakord;
 - b) shkëmbimin e shkencëtarëve, kërkuesve dhe ekspertëve teknikë;
 - c) shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit shkencor dhe teknologjik;
 - d) përdorim të përbashkët të ambienteve të kërkimit dhe zhvillimit dhe pajisjeve shkencore dhe materialeve të konsumit;
 - e) organizimin dhe marrjen pjesë në takime, konferenca, simpoziume, kurse, seminare dhe ekspozita;
 - f) ngritjen e qendrave të përbashkëta të kërkimit shkencor dhe grupeve të përbashkëta shkencore dhe të kërkimit;
 - g) forma të tjera të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik, të rëna bashkërisht dakord.
- Përveç sa më sipër, palët kontraktuese, në mënyrën më të mirë të mundur, inkurajojnë shkëmbimin e teknologjisë ndërmjet subjekteve ekonomike dhe të tjera, duke përfshirë edhe bashkëpunimin teknik.

Neni 3

Palët kontraktuese inkurajojnë dhe mbështesin bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në programet dhe projektet shkencore, teknologjike dhe të zhvillimit, shumëpalëshe dhe rajonale.

Palët kontraktuese inkurajojnë shkëmbimin e informacionit mbi prioritetet e tyre, në kuadrin e bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik në nivelin europian dhe rajonal dhe stimulojnë institutet e tyre shkencore dhe të kërkimit për të marrë pjesë së bashku në thirrjet e përbashkëta në lidhje me rajonin.

Neni 4

Shkencëtarët, kërkuesit, ekspertët teknikë dhe institucionet nga vende të tjera ose organizata ndërkombëtare mund të ftohen, me pëlqimin e të dyja palëve bashkëpunuese, të marrin pjesë në projekte dhe programe që zbatohen sipas kësaj Marrëveshjeje, për qëllimin e financimit dhe realizimit të programeve dhe projekteve, që rrjedhin nga bashkëpunimi sipas kësaj Marrëveshjeje.

Shpenzimet për këtë bashkëpunim normalisht mbulohen nga këto palë të treta, përveç kur palët kontraktuese bien dakord ndryshe me shkrim.

Neni 5

Shfrytëzimi i të drejtave të pronësisë intelektuale që rrjedhin nga aktivitetet e bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje rregullohet me anë të marrëveshjeve zbatuese ndërmjet palëve pjesëmarrëse, që sigurojnë mbrojtjen e përshtatshme dhe efektive të të drejtave të pronësisë intelektuale, në pajtim me legjislacionin e brendshëm të të dyja palëve dhe konventave ndërkombëtare në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, anëtare të të cilëve janë palët kontraktuese.

Neni 6

Rezultatet shkencore dhe teknologjike, d.m.th, shpikjet shkencore dhe çdo informacion tjetër që rrjedh nga aktivitetet e bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje, që nuk përfshihen brenda të drejtave të pronësisë industriale dhe nuk përmbajnë të dhëna që, sipas legjislacionit të brendshëm, i nënshtrohen konfidencialitetit, nuk deklarohen ndaj palëve të treta, pa pëlqimin paraprak të të dyja palëve me shkrim, përveç kur organizatat pjesëmarrëse për secilin projekt bien dakord ndryshe me shkrim.

Neni 7

Për qëllimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje ngrihet një komision i përbashkët, i përbërë nga përfaqësues të caktuar nga të dyja palët kontraktuese dhe përbëhet nga një numër i njëjtë përfaqësuesish dhe ekspertësh, të deleguar nga secila palë kontraktuese.

Detyrat e komisionit të përbashkët janë si më poshtë:

- a) identifikimi i fushave të bashkëpunimit mbi bazën e informacionit të marrë nga institucionet e secilit vend dhe politikat përkatëse kombëtare në shkencë dhe teknologji;
- b) krijimi i kushteve të favorshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
- c) lehtësimi dhe mbështetja e zbatimit të programeve dhe projekteve të përbashkëta;
- d) shqyrtimi i përparimit të aktiviteteve në lidhje me këtë Marrëveshje;
- e) shkëmbimi i eksperiencës që rrjedh nga bashkëpunimi dypalësh shkencor dhe teknologjik dhe shqyrtimi i propozimeve për zhvillimin e tij të mëtejshëm.

Komisioni i përbashkët mbahet të paktën një herë në 2 (dy) vjet, përveç kur bihet dakord ndryshe, në mënyrë alternative në Shqipëri dhe Mal të Zi, në data për të cilat bihet dakord bashkërisht, dhe përfundon e nënshkruan protokolle që përmbajnë vlerësimin e aktiviteteve të shkuara dhe të tashme dhe qëllimet e ardhshme të bashkëpunimit, si dhe listën e projekteve të bashkëpunimit të pranuar bashkërisht pas vlerësimit të propozimeve të përbashkëta që janë bërë.

Komisioni i përbashkët mund të përpilojë rregullat e veta të procedurës.

Neni 8

Me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik, komisioni i përbashkët do të miratojë një program ekzekutiv, që do të përfshihet në një prej protokolleve të tij të përmendur në paragrafin 3 të nenit 7. Programi ekzekutiv përcakton:

- a) fushat e bashkëpunimit;
- b) projekte specifike;
- c) institucionet përgjegjëse për realizimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta, këtu të quajtur “partnerë bashkëpunues”, veçanërisht: agjencitë qeveritare, subjektet shkencore, subjektet e kërkimit dhe zhvillimit, shoqatat shkencore dhe njësi të tjera organizative, duke përfshirë shoqëri private dhe publike. Përcaktimi i partnerëve bashkëpunues, sipas ligjit të secilës palë kontraktuese, do të bëhet nga komisioni i përbashkët;
- d) mënyrat e përdorimit të rezultateve të projekteve të përbashkëta të kërkimit dhe zhvillimit;
- e) burimet dhe kushtet financiare;
- f) rregullat dhe procedurat që rregullojnë zbatimin e projekteve të përbashkëta.

Shpenzimet për shkëmbimin e shkencëtarëve, kërkuesve, ekspertëve teknikë dhe specialistë të tjerë, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përveç kur bihet dakord ndryshe, mbulohen në mënyrën e mëposhtme:

- a) Pala dërguese mbulon shpenzimet e transportit në vajtje dhe kthim ndërmjet dy kryeqyteteve të të dy vendeve;
- b) Pala pritëse mbulon shpenzimet e udhëtimit brenda territorit të saj dhe qëndrimin e plotë, d.m.th, fjetje dhe dietë, sipas rregullave të çdo vendi.

Neni 9

Çdo mospërputhje, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ndërmjet palëve kontraktuese, zgjidhet me rrugë diplomatike.

Neni 10

Në lidhje me aktivitetet e bashkëpunimit të vendosura sipas kësaj Marrëveshjeje, secila palë kontraktuese në pajtim me ligjet dhe rregullat e saj, merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar kushtet më të mira të mundshme për zbatimin e tyre.

Neni 11

Kjo Marrëveshje nuk ndikon ose nuk cenon vlefshmërinë ose ekzekutimin e asnjë detyrimi që rrjedh nga traktatet ose marrëveshjet e tjera që lidhen ndërmjet palëve kontraktuese, duke përfshirë ato që rrjedhin nga Bashkimi Europian.

Neni 12

Organizatat e caktuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Malit të Zi.

Neni 13

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën kur të dyja palët kontraktuese kanë njoftuar njëra - tjetrën që procedurat e brendshme ligjore, të kërkuara për hyrjen e saj në fuqi, janë përbushur. Data e njoftimit të fundit konsiderohet të jetë data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë prej pesë vjetësh dhe rinovohet automatikisht për periudha pasuese pesëvjeçare, përveç kur një palë kontraktuese njofton tjetrën me shkrim, me rrugë diplomatike, në lidhje me qëllimin e saj për ta prishur këtë marrëveshje të paktën gjashtë muaj para datës së pushimit të fuqisë të periudhës së parë ose të një periudhe pasuese.

Ndryshimet e dispozitave të kësaj marrëveshjeje nuk bëhen pa pëlqimin e mëparshëm të dy Palëve Kontraktuese.

Modifikimet dhe pushimi i fuqisë së kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë projektet dhe programet e marra përsipër sipas kësaj Marrëveshjeje dhe nuk janë ekzekutuar plotësisht në momentin e pushimit të fuqisë së kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Podgoricë, më 16.12.2008 në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhje mbizotëron versioni në gjuhën angleze.

Për Këshillin e Ministrave të RSH FATOS BEJA	Për qeverinë e Malit të Zi SRETEN ŠKULETIĆ
---	---

VENDIM
Nr.41, datë 14.1.2009

**PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË LEJES SË KONCESIONIT “ARMO” SHA, TIRANË,
PËR PËRPUNIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dhënies së lejes së koncesionit “Armo” sh.a. Tiranë, për përpunimin e naftës, gazit dhe të nënprodukteve të tyre, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

Në mbështetje të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar:

I jepet shoqërisë anonime “ARMO”
Me seli: Kompleksi “Xhyra” – Tiranë

LEJE KONCESIONI

PËR PËRPUNIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË
TYRE

Afati i vlefshmërisë: 30 (tridhjetë) vjet

Për përdorimin nga shoqëria “ALBANIAN RAFINERING AND MARKETING OF OIL-ARMO sh.a. krijuar, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.756, datë 26.11.1998 “Për ristrukturimin e Albpetrol, sh.a. të rafinerive:

- Kombinati i përpunimit të thellë të naftës (KPTHN) me vendndodhje në qytetin e Ballshit.
- Uzina e përpunimit të naftës (UPN) me vendndodhje në qytetin e Fierit.

Miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave

Nr.____Datë ____/____/____

UDHËZIM
Nr.385, datë 16.1.2009

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1638, DATË
17.12.2008 “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË
PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave nxjerrin këtë

UDHËZIM:

1. Në zbatim të pikës 1, kapitulli 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, të gjitha miratimet e privatizimit, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të konsiderohen të vlefshme. Afati i plotësimit të dokumentacionit në këtë rast do të fillojë me ngritjen e komisionit të vlerësimit në zbatim të kreut 1, pika 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008.

2. Në zbatim të pikës 2, kapitulli I, institucionet qendrore dhe organet e njëjësive të qeverisjes vendore dërgojnë prononcimin e tyre për privatizimin e pasurive të ndërmarrjeve apo institucioneve, në administrim apo pronësi të tyre, në ministrinë përgjegjëse për privatizimin e pronës shtetërore.

Për të përfshirë në procesin e privatizimit pronat, të cilat i kanë kaluar në pronësi pushtetit vendor, nevojitet miratimi përkatës i këshillit bashkiak/të komunës apo qarkut, ndërsa për pronat të cilat janë në administrim të këtyre institucioneve, nevojitet vetëm miratimi i kryetarit të bashkisë/komunës apo qarkut përkatës.

3. Vlerësimi i pasurisë shtetërore në zbatim të këtij vendimi bëhet për çdo element të pasurisë nga komisioni i vlerësimit, duke përcaktuar vlerën reale të tregut, në zbatim të legjislacionit në fuqi duke përdorur metodat e vlerësimit të tregut.

4. Komisioni i vlerësimit për pasuritë e paluajtshme ngrihet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Ky komision do të ketë jo më pak se tre anëtarë, do të drejtohet nga kryetari i degës së shoqërive publike në prefekturën përkatëse ku ndodhet objekti dhe në përbërje të tij do të jenë përfaqësuesi i ndërmarrjes apo i institucionit, në administrim të të cilit ndodhet objekti, si dhe grupi i ekspertëve vlerësues. Ky grup ekspertësh përbëhet nga ekspertë vlerësues të pasurisë së paluajtshme, si dhe ekspert kontabël grup të autorizuar të fushës përkatëse, sipas rastit.

5. Në zbatim të pikës 5, kapitulli I, miratimi për përfshirjen në procesin e privatizimit të pasurisë së luajtshme, si elemente të veçanta, bëhet nga institucioni përkatës i varësisë administrative. Pas nxjerrjes së miratimit të privatizimit, ky institucion ngre komisionin e vlerësimit, i cili kryen vlerësimin e pasurisë. Ky komision duhet të ketë jo më pak se 3 anëtarë, kryesohet nga përfaqësuesi përkatës i strukturës administrative dhe në përbërje të tij duhet të ketë një ekspert vlerësues të fushës përkatëse.

Shpenzimet për përgatitjen e dokumentacionit të vlerësimit (pagesa e ekspertëve etj.), në rastin e mësipërm, mbulohen nga institucioni ose ndërmarrja, në administrim të të cilit ndodhet pasuria.

6. Ekspertët në përbërje të komisionit, hartojnë aktet vlerësuese, genplanet etj., si dhe përcaktojnë çmimin e shitjes së truallit në zonën përkatëse, nisur nga harta e vlerës së tokës miratuar me vendime të Këshillit të Ministrave.

Komisioni i vlerësimit dhe ekspertët përkatës mbajnë përgjegjësi ligjore për saktësinë e vlerësimit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të nënshkruar prej tyre.

7. Ekspertët në përbërje të komisionit të vlerësimit të pronës së paluajtshme shtetërore, përzgjidhen nga ministri përgjegjës për ekonominë.

8. Komisioni i vlerësimit, me marrjen e urdhrat përkatës, inspekton dhe verifikon gjendjen reale të objektit.

Ekspertët hartojnë programin e punës ku duhet të argumentojnë kohën e nevojshme për vlerësim (orët e punës), i cili do t'i dorëzohet kryetarit të degës së shoqërive publike.

Pas verifikimit dhe saktësimit të punës së realizuar të ekspertëve nga dega e shoqërive publike, hartohet procesverbali lidhur me orët e domosdoshme për vlerësimin e objektit, i cili firmoset dhe vuloset nga kryetari i degës së shoqërive publike dhe ekspertët.

Ky procesverbal në origjinal përcillet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe më pas hartohet kontrata e pagesës së ekspertëve ndërmjet tyre dhe Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Tregtare pranë kësaj ministrie.

Në këtë rast pagesa e ekspertëve lidhur me misionin e vlerësimit do të bëhet për çdo miratim privatizimi. Paga orare do të jetë 1500 lekë (një mijë e pesëqind) për orë pune.

Në rastin e vlerësimit të objekteve që do të përfshihen në fondin e kompensimit fizik për ish-pronarët, pagesa e ekspertëve do të bëhet sipas procedurës së mësipërme për çdo objekt të vlerësuar dhe paga orare do të jetë 1500 lekë (një mijë e pesëqind) lekë për orë pune.

9. Pagesa e ekspertëve, sipas pikës 8, do të kryhet nga të ardhurat nga privatizimi i pronës shtetërore, të arkëtuara në favor të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

10. Pagesa e ekspertëve që kryejnë vlerësimin e pasurive të shoqërive tregtare shtetërore, të formës anonime ose me përgjegjësi të kufizuar, të pasurisë së ndërmarrjes që transformohet në shoqëri tregtare, si dhe të objekteve të zbritura nga kapitali i shoqërisë për efekt privatizimi, mbulohet nga shoqëritë përkatëse. Në rast mospagese nga ana e shoqërisë, atëherë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës merr përsipër pagesën e ekspertëve. Kontrata e pagesës së ekspertëve do të lidhet ndërmjet ekspertëve dhe titullarit të shoqërisë.

11. Në zbatim të pikës 6, kapitulli I, ministri përgjegjës për ekonominë, miraton përfshirjen në procesin e privatizimit dhe urdhëron ngritjen e komisionit të vlerësimit për objektet ndërtimore, të cilat kanë qenë në administrim të një subjekti që nuk ekziston më.

12. Trualli që privatizohet konsiderohet sipërfaqja nën objekt dhe sipërfaqja funksionale rreth tij, e përcaktuar sipas genplanit të objektit që është pjesë e dokumentacionit të privatizimit që përgatit komisioni i vlerësimit të ndërmarrjes sipas pikave 3 dhe 4 të kapitullit II të këtij vendimi dhe konfirmimin e urbanistikës së prefekturës përkatëse.

13. Kur objekti është me dy a më shumë kate dhe në të ka disa pronarë, atëherë shitja e truallit në bazë të kërkesës së tyre për çdo pronar bëhet në bashkëpronësi të pandashme mes pronarëve të objektit. Bashkëpronarët u nënshtrohen dispozitave të Kodit Civil, p.sh.

-Objekti me 3 kate është ndërtuar mbi një sipërfaqe 500 m² (sipërfaqe ndërtimi + mjedisin e përbashkët + sipërfaqen e bordurës + sipërfaqen e truallit në oborr, nëse ka).

-Sipërfaqja e ndërtimit për ambientet e përbashkëta është 1250 m² dhe për çdo kat është: kati i I-rë 450 m² dhe kati i II-të 450 m² dhe kati III-të 350 m².

- Llogarisim koeficientin (k)

$$K = \frac{\text{Sipërfaqe trualli}}{\text{Sipërfaqe ndërtimi}}$$

$$K = \frac{500m^2}{1250m^2}$$

$$K = 0.4$$

Koeficienti është konstant, duke u shumëzuar me sipërfaqet përkatëse të ndërtimit që zë secili pronar, jep sipërfaqen përkatëse që i takon të privatizojë secili pronar. Në një kat mund të jenë një ose më shumë pronarë. Në rastin tonë në shembull kemi vetëm nga një pronar në çdo kat. Konkretisht:

Për katin I-rë	$450 \text{ m}^2 * 0.4 = 180 \text{ m}^2$
Për katin II-të	$450 \text{ m}^2 * 0.4 = 180 \text{ m}^2$
Për katin III-të	$350 \text{ m}^2 * 0.4 = 140 \text{ m}^2$

Këto sipërfaqe, të cilat përcaktohen nga ekspertët vlerësues, duke u shumëzuar me çmimin për m² të llogaritur nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Truallit ish-pronarëve, japin vleftën që duhet të paguajë në lekë secili pronar.

14. Në zbatim të pikës 11, kreu i II-të, për rastet e privatizimit tërësor të ndërmarrjeve, të linjave të shërbimit dhe të prodhimit, të objekteve së bashku me makineritë, pajisjet, mjetet e xhiros etj., që janë pjesë përbërëse të objektit: dokumentacioni i vlerësimit të objekteve ndërtimore të veçanta, pasi të kenë kaluar të gjitha procedurat (një kopje duhet të jetë origjinale), përcillet në 2 kopje (një kopje origjinale) në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila pasi e gjen të rregullt e dërgon në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike). Ndërsa dokumentacioni i vlerësimit të pasurive të luajtshme, si makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, mjetet e xhiros etj., që privatizohen të veçuara, pasi përgatitet nga komisioni i vlerësimit, përcillet prej tij në degën e shoqërive publike përkatëse, e cila pas kontrollit e dërgon në Ministrinë e Financave (Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike).

15. Në zbatim të pikës 8, kapitulli IV, vlerësimi i aseteve, kontrata e shitjes së të cilave është shpallur e pavlefshme nga gjykata, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme dhe dosjet e tyre janë kthyer në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Financave, bëhet nga komisioni i vlerësimit, i ngritur për këtë qëllim nga ministri përgjegjës për ekonominë sipas gjendjes faktike të tyre duke përcaktuar vlerën e tregut.

16. Në zbatim të pikës 3, germa “a”, kreu III të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008, për rastet e shitjes së objekteve për të cilat është konfirmuar se ka pronar truall, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, afishon njoftimin në ambientet e saj, ndërsa dega e shoqërive publike përkatëse (sipas të dhënave të dërguara nga DASHPP) në objekt dhe ambientet e ndërmarrjes që e administron atë.

Ish-pronari i truallit që dëshiron të blejë objektin duhet të paraqitet pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, brenda një afati 20-ditor nga dita e publikimit (afishimit) duke depozituar kërkesën me shkrim, në të cilën shprehet se dëshiron të blejë objektin në fjalë, dokumentacionin që vërteton pagesën prej 20% të vlerës totale të objektit (mjete kryesore + mjete xhiro), pa vlerën e truallit të objektit që kërkon të blejë, vendimin përkatës të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve të noterizuar, të shoqëruar me planvendosjen e pronës apo çdo dokument tjetër ligjor të regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i cili përcakton se ai është pronar i tokës, si dhe dëshmi trashëgimie, prokurë të posaçme përfaqësimi dhe marrëveshje të dokumentuara midis bashkëpronarëve, kur ka të tilla.

17. Në rast se ish-pronari i truallit, sipas përcaktimit të pikës 3, germa “g”, kapitulli i III-të i këtij vendimi, nuk paraqitet për blerjen e objektit që ndodhet në truallin e tij, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave realizon shitjen me ankand të objektit dhe të truallit, sipas procedurave të këtij vendimi. Vlera e truallit, e përcaktuar sipas hartës së vlerës dhe që ndodhet në dosjen e vlerësimit të objektit, do të përdoret drejtpërsëdrejti për të kompensuar ish-pronarin.

18. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, për rastet e shitjes së objektit personave të tretë nëpërmjet ankandit apo të pasurive të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteoze, kur ka të identifikuar pronarë truall, për vlerën e truallit të shitur, njofton me shkrim sektorin e financës dhe buxhetit në Ministrinë e Financave, e cila duhet të derdhë, në favor të pronarit të truallit vlerën e truallit përkatës për kompensim financiar.

Njoftimit me shkrim duhet t'i bashkëlidhet dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për ish-pronarin;
- Kontrata e shitjes së objektit bashkë me truallin;
- Autorizimi për kalim pronësie;

- Mandatpagesat që lidhen me pagesat e truallit.

Ish-pronari i truallit që do të përfitojë kompensim financiar duhet të paraqesë në Ministrinë e Financave (sektori i financës dhe buxhetit) dokumentacionin ligjor si më poshtë:

- Kërkesën me shkrim për kompensim financiar për truallin ish-pronë e tij;
- Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë apo certifikatë me fotografi);
- Dëshmi trashëgimie;
- Prokurë të posaçme përfaqësimi.

Numrin e llogarisë personale të hapur pranë Raiffeisen Bank.

19. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, pas njoftimit të marrë nga sektori i financës dhe buxhetit në Ministrinë e Financave, njofton me shkrim Zyrën Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe AKKP për kompensimin financiar të kryer në favor të subjekteve të shpronësuara jo më vonë se 5 ditë nga data e realizimit të kompensimit financiar.

20. Në rastet kur konfirmohet se objekti nuk ndodhet në truallin e subjekteve të shpronësuara, ai i nënshtrohet ankandit sipas procedurave të këtij vendimi dhe në qoftë se ditën e zhvillimit të ankandit paraqitet subjekti i shpronësuar me dokumentet përkatëse të pronësisë, atëherë ai gëzon të drejtën e parablerjes së objektit me vlerën fillestare të tij. Për rastet kur komisioni i ankandit ka vështirësi në vlerësimin e dokumentacionit të pronësisë së paraqitur nga pronari i truallit, atëherë komisioni i ankandit administron kërkesat e paraqitura për blerjen e objektit, si dhe dokumentacionin e pronësisë të paraqitur nga subjektet e shpronësuara pretendente për pronarë truall të objektit që privatizohet dhe shtyn procedurën e zhvillimit të ankandit me miratim edhe të drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, deri në konfirmimin e dokumentacionit të pronësisë së truallit nga organet përkatëse (ZRKKP, ZVRPP).

21. Kur ish-pronari i truallit është pronar i objektit duke përdorur të drejtën e parablerjes sipas pikës 3, germa “a”, kapitulli III, truall kalon në favor të tij pa shpërblim.

22. Në zbatim të pikës 18, kreu III i këtij vendimi, për rastet kur në ankandin për shitjen e objekteve apo asetëve me vlerë fillestare dhe me vlerë të ulur paraqitet vetëm një kërkesë përpara komisionit të ankandit, komisioni duhet ta evidentojë këtë kërkesë në procesverbalin e ankandit dhe objekti t’i nënshtrohet procedurës së ripublikimit për një periudhë 10-ditore në një gazetë me qarkullim kombëtar dhe me afishe, dhe në rast të mos paraqitjes të kërkesave të tjera edhe pas këtij publikimi, DASHPP realizon shitjen e objektit bashkë me truallin kërkesës së vetme të paraqitur për blerje.

23. Në zbatim të pikës 11, kapitulli i II-të i këtij vendimi, me mbërritjen e dokumentacionit të privatizimit për shitjen e makinerive, automjeteve, pajisjeve dhe mjeteve të punës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike afishon njoftimin në ambientet e saj dhe një kopje të afishimit e dërgon në degën e shoqërive publike të prefekturës ku ndodhet ndërmarrja që i ka në administrim ato për t’i afishuar në ambientet e saj.

24. Në zbatim të pikës 7, kreu III të këtij vendimi, ankandi do të zhvillohet mbi vlerën e mjeteve kryesore+ vlera e truallit, ndërsa vlera e mjeteve të xhiros do të shtohet sipas inventarit fizik, në çastin e dorëzimit të objektit.

25. Gjithashtu Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, me urdhër të drejtorit, si dhe me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, mund të përdorë edhe forma të tjera publikimi në media televizive, postera etj. Shpenzimet e publikimit do të përballohen nga të ardhurat e privatizimit.

26. Në zbatim të pikës 12, kapitulli III, pjesëmarrësit në ankand në vendin, datën dhe orën e njoftuar duhet të paraqesin pranë komisionit të ankandit edhe dokumentin e identifikimit të tyre (letërnjoftim, certifikatë me fotografi). Disa persona kanë të drejtën e paraqitjes për blerje të objektit së bashku me një kërkesë të vetme. Kjo kërkesë duhet të shoqërohet me dokumentin bankar që përmban emrat e personave që bashkohen në këtë blerje. Në rast të paraqitjes së një blerësi, personat e tjerë kërkues duhet të përfaqësohen me prokurë të posaçme.

27. Në zbatim të pikës 26, kreu i III-të, i këtij vendimi, vetëm ish-pronarët e truallit që gëzojnë të drejtën e parablerjes së objektit që privatizohet, 80% të vlerës së objektit do ta paguajnë me letra me vlerë dhe bono privatizimi nga i cili 20% është paguar për pjesëmarrje në blerje me lekë CASH.

Pagesat si me lekë CASH për pjesëmarrje në blerjen e objektit, si dhe pagesa me letra me vlerë dhe bono privatizimi do të bëhet pranë Raiffeisen Bank në numrat e llogarisë të afishuara në dokumentacionin e shitjes nga Ministria e Financave (DASHPP) për llogari të kësaj ministrie.

Banka Raiffeisen të gjitha letrat me vlerë dhe bonot e privatizimit për efekt privatizimi, sipas kësaj pike, do t'i bëjë ato të pavlefshme dhe në fund të çdo 6-mujori do t'i dorëzojë në Bankën e Shqipërisë.

28. Në rastin kur është konfirmuar në dosjen e vlerësimit apo kur subjektet e shpronësuara të truallit të objektit kanë paraqitur dokumentacionin përkatës të pronësisë dhe kërkesën për blerjen e objektit sipas pikës së 13 të kapitullit III, por nuk paraqiten në ankandin e objektit që ndodhet në pronën e tyre, komisioni i ankandit evidenton kërkesat për blerje në procesverbalin përkatës dhe cakton një datë tjetër për zhvillimin e tij brenda shtatë ditëve nga data e mëparshme e zhvillimit të ankandit, duke njoftuar edhe një herë pronarët e truallit. Nëse edhe në këtë datë pronarët e truallit nuk paraqiten për blerjen e objektit me të drejtën e parablerjes, atëherë Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike do të veprojë sipas pikës 3, germa "b", kapitulli III i këtij vendimi.

29. Në zbatim të pikës 28, kreu i III, personi që ka fituar të drejtën e blerjes për objektin dhe nuk paguan vlerën e plotë të tij brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij si fitues ankandi apo pronar truall, humbet vlerën prej 20% të paguar për pjesëmarrje në ankand, si dhe të drejtën për të marrë pjesë përsëri në ankandin që do të zhvillohet për rishitjen e objektit në fjalë.

30. Në zbatim të pikës 35, kapitulli III i këtij vendimi, vlerësimi i investimeve të pasurisë të paluajtshme në rastet e pasurive shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteozë, do të bëhet nga ekspertë vlerësues të licencuar të pasurisë dhe eksperti kontabël, i autorizuar, të miratuar nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i cili urdhëron fillimin e procedurës së mësipërme.

31. Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike, sektori i monitorimit të qirasë, në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i paraqet për miratim Ministrin të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës vlerën e investimeve të kryera nga qiramarrësi dhe të vlerësuar nga ekspertët përkatës. Me miratimin e vlerës së investimeve, Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike bën krahasimin e kësaj vlere dhe vlerës së truallit, të përcaktuar sipas çmimit të truallit të konfirmuar nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe sipërfaqes së truallit në kontratën e qiramarrjes. Nëse vlera e investimeve të kryera është mbi 150% e vlerës së truallit, Ministri nxjerr urdhrin për përgatitjen e dokumentacionit të privatizimit në favor të investitorit.

32. Shitja e pasurive shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteoze, sipas përcaktimit në pikën 35, kapitulli i III-të i këtij vendimi, realizohet nga DASHPP në Ministrinë e Financave.

DASHPP njofton me shkrim subjektin që ka pasurinë shtetërore me kontratë qiraje apo enfiteoze në të cilin i kërkon që brenda 20 ditëve nga data e njoftimit të shprehë interesin për blerjen e objektit bashkë me truallin.

Në këtë njoftim duhet të jetë përcaktuar dokumentacioni që qiramarrësi apo enfiteozmarrësi duhet të paraqesë për shprehjen e interesit për blerjen e objektit si më poshtë:

- Kërkesën me shkrim për blerjen e objektit bashkë me truallin që ai ka me qira apo enfiteozë.

- Pagesa e vlerës prej 20% të vlerës së objektit + vlerën e mjeteve të xhiros, nëse ka dhe + vlerën e truallit.

- Kopje të noterizuar të kontratës së qirasë, apo të enfiteozës për objektin.

- Nëse qiramarrësi apo enfiteozmarrësi është shoqëri tregtare, dokumentacionin ligjor të shoqërisë.

- Me plotësimin e dokumentacionit të mësipërm nga subjekti qiramarrës apo enfiteozmarrës, dorëzimin e tyre në DASHPP, kjo e fundit pajis subjektin me autorizim për kalim pronësie, në të cilin duhet të jenë të përcaktuar qartë detyrimet e blerësit.

Ministria e Financave (DASHPP) i kërkon Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës konfirmimin për pagesën e qirasë nga subjekti përkatës deri në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes.

33. Pagesa e vlerës së plotë të objektit dhe e truallit për pasuritë shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteoze do të bëhet vetëm me lekë CASH. Kontrata e shitjes së truallit do të jetë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes së objektit.

34. Në zbatim të pikës 11, kapitullit IV, punonjësit specialistë, farmacistë ose stomatologë, që kanë aktualisht kontratë qiraje për objektin, kanë të drejtën e parablerjes (me kushtin që këto specialistë të kenë zbatuar me korrektësi kontratën e qirasë, të jenë regjistruar në organet tatimore për ushtrim aktiviteti, të ushtrojnë profesionin në objektin përkatës etj.) sipas çmimit të përcaktuar të ankand (çmimi më i lartë i dhënë nga pjesëmarrësit në ankand u ofrohet punonjësve të këtij shërbimi, në rast se çmimi i arritur në ankand nuk pranohet nga punonjësit e këtij shërbimi, atëherë komisioni shpall fitues pjesëmarrësin që ka dhënë çmimin më të lartë në ankand), vetëm në ato raste kur për këto objekte nuk ka pronarë truallit të njohur me vendime të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, të cilët kanë të drejtën e parablerjes.

35. Pagesa e vlerës së plotë të objektit dhe e truallit për pasuritë shtetërore të dhëna me kontratë qiraje apo enfiteoze do të bëhet vetëm me lekë CASH. Kontrata e shitjes së truallit do të jetë pjesë përbërëse e kontratës së shitjes së objektit.

36. Në zbatim të pikës 11, kapitullit të IV-t, punonjësit specialistë, farmacistë ose stomatologë, që kanë aktualisht kontratë qiraje për objektin, kanë të drejtën e parablerjes (me kushtin që këta specialistë të kenë zbatuar me korrektësi kontratën e qirasë, të jenë regjistruar në organet tatimore për ushtrim aktiviteti, të ushtrojnë profesionin në objektin përkatës etj.), sipas çmimit të përcaktuar në ankand (çmimi më i lartë i dhënë nga pjesëmarrësit në ankand u ofrohet punonjësve të këtij shërbimi, në rast se çmimi i arritur në ankand nuk pranohet nga punonjësit e këtij shërbimi, atëherë komisioni shpall fitues pjesëmarrësin që ka dhënë çmimin më të lartë në ankand), vetëm në ato raste kur për këto objekte nuk ka pronarë truallit të njohur me vendime të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, të cilët kanë të drejtën e parablerjes.

37. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, për raste kur në dokumentacionin e vlerësimit të objektit të dërguar për privatizim, nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës konstaton mospërputhje të hartës treguese me genplanin e dosjes apo ka mungesa të të dhënave hartografike në HTR etj., kërkon informacion plotësues nga ZVRPP.

38. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1638, datë 17.12.2008 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes” dhe këtij udhëzimi për zbatimin e këtij vendimi ka të drejtë të hartojë dhe të miratojë rregulloren e brendshme për zhvillimin e ankandit, si dhe të nxjerrë urdhrat përkatëse në përputhje të akteve ligjore në fuqi, për të rritur efikasitetin e privatizimit.

39. Publikimi për shitje për objektin që do të privatizohet, përveç informacionit plotësues të përcaktuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, përmban edhe tabelën me të dhënat, sipas formatit si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlera fillestare e objektit (lekë) (Mjete kryesore+vlera e truallit)	Mjete xhiroje (në lekë)	Sipërfaqja gjithsej e objektit (në m ²)	Sipërfaqja e nënobjektit (në m ²)	Vlera e truallit (në lekë)
1							
2							
3							

40. Për rastet e publikimit (afishimit) për ish-pronarët e truallit, tabela do të jetë me të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Ermërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlera fillestare e objektit (lekë) (Mjete kryesore+mjetet e xhiros)	Mjete xhiroje (në lekë)	Sipërfaqja gjithsej e objektit (në m ²)	Sipërfaqja e nënobjektit (në m ²)	Vlera e truallit (në lekë)
1							
2							
3							

41. Në zbatim të pikës 33, kreu i III-të i këtij vendimi, dokumentacionet e vlerësimit të objekteve ndërtimore të pashitura edhe pas zbatimit të të gjitha fazave të shitjes së këtij vendimi, do të përcillen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dhe kjo e fundit i dërgon pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për t'u përdorur si fond kompensimi fizik. Ndërsa dosjet e vlerësimit të makinerive, pajisjeve etj., të cilat kanë mbaruar procedurën e privatizimit dhe rezultojnë të pashitura kthehen në degën e shoqërive publike të prefekturës përkatëse, dhe kjo e fundit i kthen në ndërmarrje apo institucionin e varësisë administrative, i cili zbaton procedurat përkatëse ligjore të nxjerrjes jashtë përdorimit të tyre.

42. Në zbatim të pikës 34, kapitulli III, Ministria e Financave (DASHPP) dërgon në datën 20 të çdo muaji në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës evidencën statistikore të shitjeve, si dhe një kopje të kontratës së shitjes të çdo objekti ndërtimor.

43. Udhëzimi nr.6364, datë 3.7.2008 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.794, datë 21.11.2007 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes"", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.7, datë 22.1.2009

PËR FORMATIN E GJOBËS

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 47 pika 6 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Procesverbali i gjobës së vendosur nga inspektorët e NJMLF-së, në zbatim të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", të mbahet në tri kopje dhe sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.504, datë 22.1.2009

PËR RIJETËZIMIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të pikës 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për dhënien me qira të pasurive shtetërore”, si dhe në vijim të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Monumentet e kulturës që rijetëzohen, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet.

1. Monumentet e kulturës rijetëzohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

2. Kriteret e vlerësimit të konkurrimit në rijetëzimin e monumenteve të kulturës (dhënien me qira) janë si më poshtë vijon :

a) Projektpreventivi i restaurimit dhe rijetëzimit në tri kopje, i hartuar nga subjekte të licencuara ose institucione shtetërore të specializuara;

b) Projekt i gjendjes ekzistuese, së bashku me dokumentacionin teknik dhe fotografitë, si dhe një prezantim të plotë në power- point;

c) Niveli i investimit;

d) Niveli i punësimit;

e) Eksperiencia të mëparshme të subjektit hartues të projektit në restaurim;

f) Plotësimi i kriterëve të përcaktuara në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.426, datë 13.07.2007 “Për miratimin e kartës shqiptare të restaurimit”;

g) Tarifa e qirasë mujore.

3. Të drejtën e lidhjes së kontratës së shfrytëzimit (rijetëzimit) të monumentit e ka ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, me një afat që do të vendoset rast pas rasti nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

II. Procedurat e rijetëzimit të monumenteve të kulturës (dhënies me qira).

1. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për monumentin që rijetëzohet përgatit dokumentacionin, si vijon:

a) Propozimin për rijetëzimin e tij, i cili përmban edhe objektin e veprimtarive që mund të ushtrohen në monument.

b) Genplanin e objektit, ku të jetë shënuar sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe sipërfaqja e truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë) të konfirmuar nga IMK+ DRKK.

c) Vlerën dysheme të detyrimit mujor.

Pas përgatitjes së dokumentacionit, përgatitet urdhri i titullarit për shpalljen e procedurave për dhënien për rijetëzim.

2. Urdhri i titullarit të institucionit, për rijetëzimin me konkurrim, të monumentit të kulturës, me këtë përmbajtje:

a) Të dhënat e objektit: emërtimi, sipërfaqja, qëllimi i përdorimit, çmimi dysheme, afati.

b) Aktiviteti që mund të ushtrohet në objekt.

c) Vendi, data dhe ora ku paraqiten dokumentet e konkurruesve.

d) Përbërja e komisionit të shqyrtimit të ofertave të konkurrentëve.

e) Dokumentacioni që do të paraqitet në konkurrim nga konkurrentët.

Këtij urdhri i bashkëlidhet edhe njoftimi për publikim.

3. Njoftimi për publikim për rijetëzimin e monumentit të kulturës do të shpallet 2 herë në buletin shtetëror të njoftimeve dhe përmban: të dhënat për objektin, kategorizimin e aktivitetit, dokumentacionin që do të paraqitet nga konkurrentët, si dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 ditë kalendarike pas datës së fundit të publikimit.

4. Dokumentacioni për rijetëzimin e monumentit të kulturës, që duhet të paraqesin konkurrentët, i dorëzohet komisionit dhe përmban :

- a) Kërkesën e subjektit për rijetëzimin e monumentit të kulturës;
- b) Planbiznesin, të detajuar, për vënien në funksionim të monumentit të kulturës, ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- c) Ofertën për tarifën mujore të qirasë;
- d) Certifikatën e regjistrimit të subjektit në QKR ose vendimin e regjistrimit në gjykatë;
- e) Vërtetim nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- f) Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

6. Komisioni i vlerësimit të konkurrimit për rijetëzimet e monumenteve të kulturës kryen këto detyra :

a) Bën protokollimin e kërkesave dhe hap në prani të konkurrentëve dokumentacionin e paraqitur prej tyre. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti skualifikohet në prani të tij. Komisioni lexon dhe bën të njohur, në prani të konkurrentëve të kualifikuar për pjesëmarrje në konkurrim, të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur.

b) Harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruan pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkakun, konkurrentët e kualifikuar dhe listën e dokumenteve të paraqitura prej tyre.

c) Brenda 5 ditëve i paraqet Këshillit Kombëtar të Restaurimit një raport përmbledhës për zhvillimin e konkurrimit dhe gjithë dokumentacionin përkatës, së bashku me procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit dhe listën e konkurruesve.

7. Pas shqyrtimit të projekteve, Këshilli Kombëtar i Restaurimit vendos për subjektin fitues të konkurrimit. Subjekti fitues detyrohet të zbatojë vërejtjet teknike të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve.

8. Në përcaktimin e fituesit rëndësi e veçantë i kushtohet cilësisë së projektit më të përshtatur me monumentin dhe funksionin e tij. Rast pas rasti do të merren në konsideratë dhe parametrat për infrastrukturën dhe elementet e vizitueshmërisë të lidhura me monumentin (rrugë, ndriçim, tabela etj.). Njoftimi për shpalljen fitues vendoset në këndin e njoftimeve të MTKRS-së.

9. Subjektet konkurruese, brenda 5 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimimit te ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i cili brenda 10 ditëve i përgjigjet ankuesit me shkrim, vendimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore është përfundimtar.

10. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, komisioni i vlerësimit fillon procedurat për hartimin dhe lidhjen e kontratës shfrytëzimit e rijetëzimit të monumentit të kulturës.

11. Para nënshkrimit të kontratës së shfrytëzimit e rijetëzimit, subjekti është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës, e cila është në shumën 10% të vlerës së investimit. Garancia rri e ngurtësuar deri në fund të kontratës.

12. Zbatimi i projektit sipas vendimit të KKR-së do të kryhet nga subjekte të licencuara, kolaudimi do të bëhet nga specialistë të IMK, në përputhje ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e kartës shqiptare të restaurimit”. Specialistët do të shpërblehen në masën e caktuar në kontratë të veçantë lidhur mes subjektit fitues kolaudatorit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Ylli Pango

UDHËZIM
Nr.8, datë 26.1.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË DUHUR PËR SHTYPJEN E BILETAVE,
SHPËRNDARJEN DHE KONTROLLIN E HEDHJES SË TYRE NË PËRDORIM**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13 pika 2 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Shtypja e biletave të lojërave të fatit kryhet nga vetë shoqëritë, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e lojërave të fatit, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi.

2. Ministri i Financave, me propozim të NJMLF-së, miraton çdo biletë të re, që hidhet në qarkullim nga organizatori i lojërave të fatit. Për këtë qëllim, organizatori paraqet pranë NJMLF-së dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për miratim të biletës, shoqëruar me modelin e biletës së propozuar nga organizatori;

b) Kontratën e lidhur me prodhuesin e biletës;

c) Detaje teknike të lojës dhe biletës;

3. Bileta e propozuar nga organizatori duhet të përmbajë elementet si më poshtë:

a) Emrin e shoqërisë;

b) Të përmbajë nënshkrimin e “Miratuar nga Ministria e Financave”;

c) Çmimin e biletës në lekë (përjashtuar biletat ku çmimi përcaktohet sipas rastit);

d) Numri serial i biletës (për biletat e lojës së fatit “bingo” duhet të jetë gjithmonë progresiv);

e) Elementi i sigurisë së biletës, përfshirë numrin serial progresiv;

f) Rregullorja e lojës me çmimet përkatëse për fituesin (për biletat e lotarisë së çastit).

4. Biletat shtypen në një shtypshkronjë të akredituar brenda dhe jashtë vendit.

5. Në kontratën me shtypshkronjën do të përcaktohet data e fillimit të shtypjes së biletave, data e dorëzimit të biletave, sasia në copë e biletave, numri serial i biletave, çmimi i shtypjes së biletave, specifikimet teknike të biletave dhe vendosja e elementeve të sigurisë në biletë.

6. Organizatori depoziton pranë NJMLF-së, përpara hedhjes në qarkullim të biletës për kategorinë e lojës “lotari me fitim në çast”, CD me kodet e sigurisë dhe çmimet fituese të biletave si të prodhuara nga shtypshkronja, me të cilën organizatori ka lidhur kontratën. Kjo CD hapet vetëm në përfundim të lojës dhe në prani të organizatorit.

7. Organizatori është i detyruar të depozitojë në NJMLF regjistrin e shpërndarjes së biletave, sipas sallave apo pikave të shitjes në të gjithë territorin e vendit përpara hedhjes në qarkullim të biletës dhe të njoftojë në vazhdimësi për çdo parti të re furnizimi në këto pika shitjeje.

8. Organizatori i lotarisë së çastit/me shorte është i detyruar të publikojë në të gjitha pikat e shitjes së biletave;

a) serinë e plotë të biletave të hedhura në qarkullim në të gjithë territorin e vendit;

b) rregulloren e lojës.

9. Organizatori i lojës njofton NJMLF-në çdo 6 muaj mbi xhiron e realizuar nga shoqëria, bazuar mbi shitjen e biletave; sasinë e shitur të biletave dhe çmimet fituese, si dhe derdhjen e detyrimeve tatimore, sipas ligjit.

10. Asgjësimi i biletave bëhet vetëm me miratim të Ministrisë së Financave.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.2, datë 22.1.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“WTS ENERGJI” SHPK ME NR.16, SERIA PV04P, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S
NR.49, DATË 22.7.2004**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pika 3 dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.1.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “WTS energji” sh.p.k. dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e licencës nr.16, seria PV04P, të shoqërisë “WTS Energji” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.39, datë 22.7.2004.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.3, datë 22.1.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE-S**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 8, pika 2, germa “k” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, pika 1, germa “g” dhe 40 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.1.2009, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, “Për fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

2. Ngarkohet grupi i punës për përpunimin e ndryshimeve në rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.4, datë 22.1.2009

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË KONSUMIT VJETOR TË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR PËRFITIMIN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR PËR VITIN 2009**

Në mbështetje të nenit 48 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9501, datë 3.4.2006 “Për ratifikimin e traktatit të krijimit të komunitetit të energjisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.1.2009, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. Për vitin 2009, të gjithë klientët jofamiljarë të energjisë elektrike kanë të drejtë të përfitojnë statusin e klientit të kualifikuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.5, datë 22.1.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
RREGULLOREN PËR KRITERET E DHËNIES DHE HEQJES SË STATUSIT TË
KLIENTIT TË KUALIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, pika 1, germa “g” dhe 40, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.1.2009, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për përpunimin e ndryshimeve në rregulloren “Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.6, datë 22.1.2009

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR FURNIZIM ENERGJIE ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË) DHE SHOQËRISË OSSH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 1.7.2008 DERI MË 31.12.2008

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26, pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 111 dhe 112/2/b të Kodit të Procedurave Administrative, të miratuar me ligjin nr.8485, datë 12.5.1999, pikës 4.13 germa “A”, pika 2, të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, pikës V.1, të rregullave të tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.68, datë 23.6.2008, vendimit nr.106, datë 4.9.2008 “Për fillimin e procedurave të miratimit të kontratës së furnizimit midis KESH sh.a. dhe OSSH sh.a.”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 22.1.2009, pasi shqyrtoi draftin e kontratës për furnizimin me energji elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSSH sh.a. për periudhën 1.7.2008 deri më 31.12.2008

dhe konstatoi se:

-Me vendimin nr.106, datë 4.9.2008, Bordi i Komisionerëve ka vendosur për fillimin e procedurave të miratimit të kontratës së furnizimit midis KESH sh.a. dhe OSSH sh.a;

-Kontrata është lidhur nga KESH sh.a. dhe OSSH sh.a., subjekte të licencuara nga ERE, përkatësisht me vendimet nr.9, datë 25.1.2008 dhe nr.11, datë 23.6.2006, të ndryshuar;

-Modeli i tregut të energjisë dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike përcaktojnë se kjo kontratë i nënshtrohet tregut të rregulluar;

-Në referencë të akteve të sipërcituara, ERE është autoriteti i përcaktuar për miratimin e kësaj kontrate;

Për sa më sipër evidentuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë) dhe shoqërisë OSSH sh.a. (furnizuesi publik me pakicë) për periudhën 1.7.2008 deri më 31.12.2008.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.7, datë 26.1.2009

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË ZBATIMIT TË TARIFAVE TË SHËRBIMIT DHE
ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË DHE SHUMICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.1.2009, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve, lidhur me shtyrjen e afatit të zbatimit të tarifave të shërbimit të energjisë elektrike, të çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et ekzistuese (private apo të dhëna me koncesion) me fuqi të instaluar deri në 10 MW dhe të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW,

konstatoi se:

- Ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcakton ERE-n, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për vendosjen e tarifave të energjisë elektrike për të gjitha veprimtaritë e rregulluara.

- Me vendimin nr.87, datë 6.8.2008 “Për miratimin e deklaratës rregullatore në kuadër të zbatimit të metodologjive të llogaritjes së tarifave të energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi, ndër të tjera, ka vendosur ngrirjen e tarifave dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike.

- Me vendimin nr.87, datë 16.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar, Këshilli i Ministrave ndër të tjera ka shtuar fuqinë e instaluar nga 10 MW në 15 MW për HEC-et e rinj.

Për të gjitha sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyhet afati i zbatimit të tarifave të shërbimit të energjisë elektrike, të çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë, të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et ekzistuese (private apo të dhëna me koncesion) me fuqi të instaluar deri në 10 MW dhe të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW.

2. Lënien në fuqi deri më datë 31.12.2009 të vendimeve të Bordit të Komisionerëve, si më poshtë:

- Vendimi nr.82, datë 24.12.2007 “Për përcaktimin e shitjes së energjisë elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW për vitin 2008”;

- Vendimi nr.18, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”;

- Vendimi nr.19, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”.

- Vendimi nr.20, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes, për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”;

- Vendimi nr.21, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për konsumatorët tariforë për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”;

- Vendimi nr.22, datë 14.2.2008 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet me fuqi të instaluar deri në 10 MW për periudhën 1 mars 2008-28 shkurt 2009”.

- Vendimi nr.75, datë 26.6.2008 “Për përcaktimin e çmimit të shitjes me shumicë të energjisë elektrike nga FPSH për periudhën 1 korrik 2008-28 shkurt 2009”.

3. Efektet e shkaktuara nga lënia në fuqi e vendimeve të mësipërme, për të gjithë përbërësit e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike, do të kompensohen në çmimet dhe tarifat e shërbimeve të energjisë elektrike për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 2.2.2009
Doli nga shtypi më 4.2.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë